VENDIM
Nr. 119, datë 14.10.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENERGJIA D.O.O VETERNIK" SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "ç" dhe 110 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "f"; 5 pika 1, germa "f"; 10, pika 3, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa "a" e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.10.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Energjia D.O.O Veternik" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Energjia D.O.O Veternik" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9 , pika 4/9, germat "a", "b" dhe "c");

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), (statuti ligjor i shoqërisë), do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Energjia D.O.O Veternik" sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti